



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 8

UDHËZIM

**PËR LËVIZJEN E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE GJATË ORARIT TË
KUFIZUAR PËR LËVIZJEN E POPULLATËS**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “b”, “dh” e “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në zbatim të Urdhrit nr. 99, datë 10.02.2021, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit”, i ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Kryetarët dhe sekretarët e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe qendrave të votimit udhëzohen të kërkojnë leje për dalje gjatë orarit të kufizuar për lëvizjen e popullatës, për të përmbushur detyrat e tyre dhe të anëtareve të administratës zgjedhore, pranë komisarivateve të policisë nën juridiksionin e të cilave janë KZAZ-të dhe QV-të.
2. Kërkesat duhet të jenë të nënshkruara nga kryetari dhe të vulosura nga sekretari i komisionit dhe të jenë të evidentuara në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ngarkohen kryetarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

